



Në bazë të kërkesës së fshatit Carrabreg i Epërm, të dt.22.04.2024, nr.01-12619, për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e aktivitetit "N'Carrabreg dhuron gjak 2024", i cili mbahet me datën 29 Maj, në mbështetje të nenit 52.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), dhe nenit 51 paragrafi 51.2 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX.5, dt.31.10.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.26.04.2024, merr këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E 1500 EURO PËR AKTIVITETIN "N'CARRABREG DHURON GJAK 2024"

I.

Merret Vendimi për ndarjen e 1500 euro, për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e aktivitetit "N'Carrabreg dhuron gjak 2024", i cili mbahet me datën 29 Maj. Nga kjo shumë e mjeteve do të ndahen të hollat për fanella të dhuruesve vullnetarë të gjakut, plisa, mirënjohje, njoftime për promovimin e kësaj ngjarje si dhe organizimin e një dreke me ushqime tradicionale. Mjetet financiare do të derdhen në emër të Arton Loshaj me nr.personal 1009787824, në llogarinë rrjedhëse aktive te NLB Banka.

II.

Mjetet financiare të miratuara si në pikën I. Të këtij Vendimi ndahen nga Linja buxhetore e Zyrës së Kryetarit ose Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, në kategorinë e Subvencioneve.

III.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunë së Deçanit.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i KPF-së.

V.

Me Vendim njoftohen: Pala, Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.IV-6/2
Deçan,dt.26.04.2024

REPUBLIC OF KOSOVA OPSTINA DEÇAN	
Kryesuesi i KPF-së	
15512	
01	17.05.24

Kryesuesi i KPF-së
Hajdar SUTAJ





Në bazë të kërkesës së Riza Tolaj, kryetar i Këshillit të fshatrave Prilep dhe Prekolluk, në emër të banorëve të fshatit Prekolluk, , kërkesa e dt.23.04.2024, nr.01-12723, për ndarjen e mjeteve financiare , në shumën prej 5,000.00 euro për projektin e ndërtimit të shtëpisë së përbashkët për aktivitetet e fshatit Prekolluk, në mbështetje të nenit 52.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 51 paragrafi 51.2 të Statutit të Komunës së Deçanit, Komiteti për Politikë dhe Financa i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.26.04.2024, merr këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E 5,000.00 EURO PËR NDËRTIMIN E SHTËPISË PËR AKTIVITETET E FSHATIT PREKOLLUK

I.

Merret Vendimi për ndarjen e 5,000 € për projektin e ndërtimit të shtëpisë së përbashkët për aktivitetet e fshatit Prekolluk, si participim në projektin i cili financohet me vet iniciativë të fshatit, ku vlera totale e projektit kalon shumën 40.000 euro. Mjetet financiare do të derdhen në llogarinë rrjedhëse të Shkelzen Hadergjonaj me nr.personal 1009780145, në llogarinë rrjedhëse aktive, te NLB Banka.

II.

Mjetet financiare të miratuara si në pikën I. Të këtij Vendimi ndahen nga Linja buxhetore e Zyrës së Kryetarit ose Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, në kategorinë e Subvencioneve.

III.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Deçanit.

IV.


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

V.

Me Vendim njoftohen: Pala, Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.IV-6/3

Deçan, dt.26.04.2024



Kryesuesi i KPF-së
Hajdar SUTAJ





Në bazë të kërkesës së Shkumbin Malaj / në emër të komunitetit të fshatit Strelc i Epërm, të dt.23.04.2024, nr.01-12722, për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve për aktivitetin e dhurimit të gjakut në fshatin Strelc i Epërm, si dhe për organizimin e aktiviteteve të fshatit Strelc i Epërm, të cilat mbahen me datën 25 Maj, ditën që shënon fillimin e luftës frontale të UÇK-së në Strelc, njëkohësisht dita që nderohen dëshmorët dhe martirët e fshatit Strelc i Epërm, në mbështetje të nenit 52.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), dhe nenit 51 paragrafi 51.2 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX.5, dt.31.10.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa i Komunës së Deçanit, në mbledhjen e mbajtur me dt.26.04.2024, merr këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E 1000 EURO PËR AKTIVITETIN E DHURIMIT TË GJAKUT NË FSHATIN STRELLC I EPËRM

I.

Merret Vendimi për ndarjen e 1000 euro, për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e aktivitetin e dhurimit të gjakut në fshatin Strelc i Epërm, si dhe për organizimin e aktiviteteve të fshatit Strelc i Epërm, të cilat mbahen me datën 25 Maj, ditën që shënon fillimin e luftës frontale të UÇK-së në Strelc, njëkohësisht dita që nderohen dëshmorët dhe martirët e fshatit Strelc i Epërm. Mjetet financiare do të derdhen në emër të Shkumbin Malaj me nr.personal 1030758737, në llogarinë rrjedhëse aktive te ProCredit Bank.

II.

Mjetet financiare të miratuara si në pikën I. Të këtij Vendimi ndahen nga Linja buxhetore e Zyres së Kryetarit ose Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, në kategorinë e Subvencioneve.

III.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunë së Deçanit.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i KPF-së.

V.

Me Vendim njoftohen: Pala, Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.IV-6/1

Deçan, dt.26.04.2024

REPUBLIC OF KOSOVA MUNICIPALITY OF DEÇAN	
K.K. Deçan, As. 15517	
01	17.05.24

Kryesuesi i KPF-së
Hajdar SUTAJ





REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenin 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, publikuar në gazetën zyrtare me datën 04.06.2008, numër 28, nenit 25 të Ligjit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në Barazi gjinore Nr. 08/L-185, si dhe nenit 26 pika 3. të Statutit të komunës së Deçanit, 01.nr.IX-5, dt. 31.10.2019, me propozimin e Kryetarit të Komunës së Deçanit z. Bashkim Ramosaj, 01-12320, dt.19.04.2024, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur, me dt.30.04.2024, merr këtë:

VENDIM

Për Hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027

Neni 1

Miratohet Propozimi i Kryetarit të Komunës z. Bashkim Ramosaj, për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027, që parandalon dhe trajtonë dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe dhunën në baza gjinore, të mbrojtë dhe të kontribuojë në eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave si dhe të ndërtojë mekanizmat e nevojshëm për ofrimin e mbështetjes ndaj viktimave të gjitha formave të dhunës të rregulluara me ligj.

Neni 2

Koordinatori/ja për Mekanizmin Koordinues Lokalë për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Bazë Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryetarit e koordinon dhe udhëheq procesin e hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027.

Neni 3

Më rastin e hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027 dhe kryerjes së procedurave të konsultimeve publike, kujdeset kryetari i komunës më qëllim të procedimit për shqyrtim dhe miratim pranë Kuvendit të Komunës.

Neni 4

Hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027 do të financohet nga Buxheti i Komunës së Deçanit, në shumën që përcaktohet me Vendim të veçantë në Kuvend.

Neni 5

Vendimi hynë në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Vetëqeverisje Lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen e komunës.

01.Nr.IV-5

Deçan,dt.30.04.2024

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

	REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E DEÇANIT MUNICIPALITY OF DEÇAN OPSTINA DEÇAN
NR. PROTOKOLLIT	14451
NR. STATUTIT	01
NR. DOKUMENTIT	08.05.24

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



PROPOZIM

Ne bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d) dhe nenit 14 paragrafi 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr.28 e datës 04.06.2008, në bazë të nenit 24, paragrafi 1, 2 dhe 3, nenit 25 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr.10/03, Prill 2019), në bazë të nenit 29 dhe nenit 30 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 22, 26 dhe 56 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kryetari i Komunës së Deçanit, z.Bashkim Ramosaj, i propozon Kuvendit të Komunës së Deçanit, në mbledhjen që do të mbahet me dt.30.04.2024, i propozon të merr këtë:

VENDIM

I. TË MIRATOHET propozimi i Kryetarit të Komunës së Deçanit, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme private.

II.Sipas pikës nr.I. të këtij vendimi këmbimi përfshinë:

1. Parcela kadastrale e identifikuar me certifikatë të pronësisë Nr.00362-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 360 m², Zona kadastrale Dashinoc, me kulturë Rrugë e pakategorizuar, e regjistruar në regjistrat kadastral në emër të: PASURI SHOQËRORE RRUGË PUBLIKE TË PAKATEGORIZUARA, në pronësi të Komunës së Deçanit, Sipërfaqja që këmbëhet 205 m².
2. Prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim është pjesa e parcelës Nr.00361-2 me sipërfaqe të përgjithshme prej 820m², vendi i quajtur Oborr, Shqyrtëzimi aktual Bujqësore-Kullosë e Klasës 3, Zona kadastrale Dashinoc, pronë private me pronar Faruk Sadikaj nga fshati Dashinoc, Sipërfaqja që këmbëhet 205 m².

III.Qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme private të përshkuara në pikën II. Të këtij vendimi është : Rregullimi i kufirit të ngastrës kadastrale 00362-0, Zona Kadastrale Dashinoc, me kulturë Rrugë e pakategorizuar, me sipërfaqe të tërsishme prej 360 m², e regjistruar në regjistrat kadastralë në emër të: PASURI SHOQËRORE RRUGË TË PA KATEGORIZUARA, Sipërfaqja e ngastrës nuk ndryshon, por ndryshon vetëm forma e sajë, duke u përshtatur me gjendjen faktike në teren, rrugën e asfaltuar nga Komuna e Deçanit.

IV.Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe pronës së paluajtshme të pronarit privat.

V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhe dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbëhet.

VI.Prona e paluajtshme komunale që do të këmbëhet, e përshkruar në pikën II. Të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.

Propozimi i dërgohet Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe marrje të vendimit.

Deçan,dt.22.04.2024

Kryetari i Komunës:
Bashkim Ramosaj

VIII.Pjesë përbërse të këtij vendimi janë :

- Skica grafike,
- Kopjet e planit dhe
- Certifikatat e njësisë kadastrale.

IX.Vendimi hyn në fuqi 15(pasëmbëdhjet) dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7(shtatë) ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës në gjuhët zyrtare.

01.Nr.IV-6

Deçan,dt.30.04.2024

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



QAJEJE DEÇAN - DEÇANE REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E DEÇANIT - DEÇANE DEÇANE / DEÇAN MUNICIPALITY	
NR. DOK. / DTG. / DTG. /	K.K. Deçan AS / 14446
NR. TREGIM. / BR. VAK. / NR. DOK. /	01 / 08.05.24



Në bazë të kërkesës së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit-Departamenti i sportit, të dt.22.01.2024, nr.309-2024, për përgatitjen e dokumentacionit për ndërtimin e Pishinës gjysmë olimpike në Deçan- Vendimi i Kuvendit për ndarjen e lokacionit për Pishinë Gjysmë Olimpikë, ku kërkohet plotësim i dokumentacionit në pajtueshmëri me Ligjin e Ndërtimit Nr.04/L-110, **në pajtim me dispozitat e nenit 10, 11 dhe 15 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor**, duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenin 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr.28/2008), në bazë të nenit 22 dhe 26 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, me Rekomandim të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për Rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit, të dt.29.02.2024, Nr.933-2/24, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.30.04.2024, bie këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E PISHINËS GJYSMË OLIMPIKE NË DEÇAN

I.

Merret Vendimi për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e Pishinës Gjysmë Olimpikë në Deçan, sipas standardeve FINA (Federata Ndërkombëtare e Sporteve të Ujit) në bashkëpunim me MKRS-në (Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit).

II.

Lokacioni i caktuar për ndërtimin e Pishinës Gjysmë Olimpikë në Deçan, është në harmoni me dokumentet e planifikimit hapësinorë të Komunës së Deçanit(Plani Zhvillimor Komunal-PZHK), parcelë e planifikuar në PZHK për Sport dhe Rekreacion.

Parcela nr.00563-23, Njësia Kadastrale P-70505021-00563-23, me sipërfaqe S=4000m², Zona Kadastrale Deçan, pronar Komuna e Deçanit.

III.

Implementimin e këtij Vendimi do ta bëjnë: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Deçanit.


IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

V.

Pjesë përbërse të këtij vendimi janë :

- Skica grafike,
- Kopjet e planit dhe
- Certifikatat e njësisë kadastrale.



Me Vendim njoftohen: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.IV-7

Deçan,dt.30.04.2024

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



The image shows a handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Hajdar SUTAJ', written over a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E KOSOVES' at the top, 'KOMUNA DEÇANIT' on the left, 'Kuvendi i Komunës së Deçanit' in the center, and 'REPUBLIK OF KOSOVA' at the bottom. The stamp also features a central emblem with a map of Kosovo.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Në bazë të kërkesës së Kryetarit të Komunës, z.Bashkim Ramosaj, të dt.15.03.2024, nr.02-8485, për mbështetje financiare për realizimin e projektit Digjitalizimi i Memorialit të Dëshmorëve në Glllogjan , në mbështetje të nenit 52.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr.28 e datës 04.06.2008, dhe nenit 51 paragrafi 51.2 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5 të dt.31.10.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa i Komunës së Deçanit, në mbledhjen e mbajtur me dt.24.04.2023, merr këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E 2050 EURO PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT DIGJITALIZIMI I MEMORIALIT TË DËSHMORËVE NË GLLLOGJAN

I.

Merret Vendimi për ndarjen e ndarjen e 2050 euro për mbështetje financiare për realizimin e projektit Digjitalizimi i Memorialit të Dëshmorëve në Glllogjan .

Mjetet financiare do të derdhen në llogarinë rrjedhëse të ideatorit të projektit dhe punëkryesit, Besart Gashi, me nr.personal 1174351275, te TEB Banka.

II.

Mjetet financiare të miratuara si në pikën I. Të këtij Vendimi ndahen nga Linja buxhetore e Zyrës së Kryetarit ose Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, në kategorinë e Subvencioneve.

III.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Deçanit.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa.

V.

Me Vendim njoftohen: Pala, Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.III-3

Deçan,dt.26.03.2024

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA REPUBLIKA KOSOVA
K.K. Deçani AS	12984
01	24-04-24



Kryesuesi i KPF-së
Hajdar SUTAJ



Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr.28 e datës 04.06.2008, nenit 25 të Ligjit Nr. 08/L-185 për Parandalim dhe Mbrojtje nga Dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në Barazi gjinore, nenit 26 pika 9, të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5 të dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.30.04.2024, bie këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE 2024-2027

I.

Themelohet Komisioni për Hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027, në këtë përbërje:

1.Lendita Berisha(Asamble AAK), 2.Elmedina Sadikaj (Asamble AAK), 3.Albesa Cacaj(Asamble LDK), 4.Teuta Neziraj(Asamble VV), 5.Mon Selmonaj (Asamble PDK).

Mbledhjen e parë të Komisionit e thirrë Kryesuesi i Kuvendit, në atë mbledhje komisioni e zgjedhë Kryesuesin nga radhët e veta

II.

Detyrë e Komisionit është që në koordinim me Koordinatorin/en për Mekanizmin Koordinues Lokalë për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Bazë Gjinore, në kuadër të Zyrës së Kryetarit, që e koordinon dhe udhëheq procesin e hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027, të bëjë hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027, që parandalon dhe trajtonë dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe dhunën në baza gjinore, si dhe t'a harmonizon atë me Statutin e Komunës dhe të gjitha ligjet në fuqi. Pas përgatitjes së materialit, Komisioni i dorëzon materialin për shqyrtim dhe miratim KPF-së dhe Kuvendit.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

IV.

Me nga një kopje të Vendimit paisen, të emruarit në pikën I. dhe Arhivi.

01.Nr.IV-5/1

Deçan,dt.30.04.2024

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT MUNICIPALITY OF DEÇAN OPSTINA DEÇAN	
Nr. i vendimit 01	Nr. i datës 08.05.24
Kryesuesi i Kuvendit Hajdar SUTAJ	

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



Bazuar në Ligjin Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 30 paragrafët 30.4 dhe 30.5 dhe Ligji Nr.08/L-260 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 /neni 15 paragrafët 9 dhe 10 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 26 / 29 Dhjetor 2023), në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr.28 e datës 04.06.2008, dhe nenit 26 pika 2. të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, të datës 31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.30.04.2024, merr këtë:

V E N D I M

PËR RIDESTINIM TË MJETEVE BUXHETORE NGA KATEGORIA MALLRA DHE SHËRBIME NË KATEGORINË SUBVENCIONE

I.

Merret Vendimi për Ridestinim të mjeteve buxhetore nga kategoria Mallra dhe Shërbime në kategorinë Subvencione, sipas të dhënave të prezantuara në vijim:

- 1. Mjetet financiare për ridestinim në vlerë prej 50,000.00 € (pesëdhjetmijeu) janë: nga kategoria Mallra dhe Shërbime, Zyra e Kryetarit, kodi ekonomik:22/631/16015/130/0111, ridestinohen në kategorinë Subvencione, Zyra e Kryetarit, kodi ekonomik: 22/631/16015/200/0111.**

II.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdeset, Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Deçanit.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

IV.

Me Vendim njoftohen:MF-Departamenti për Buxhet dhe Financa, Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arhivi i KK Deçan.

01.Nr.IV-3

Deçan,dt.30.04.2024

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA REPUBLIKA KOSOVA
	KOMUNA E DEÇANIT MUNICIPALITY OF DEÇAN OPSTINA DEÇAN
Nr. i Aktit Dok. i Aktit No. i Aktit	KK Deçan AS 14445 01 08.05.24
DEÇAN DEÇANI	

Faqe 1 nga 1



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenin 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, publikuar në gazetën zyrtare me datën 04.06.2008, numër 28, nenit 25 të Ligjit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në Barazi gjinore Nr. 08/L-185, si dhe nenit 26 pika 3. të Statutit të komunës së Deçanit, 01.nr.IX-5, dt. 31.10.2019, me propozimin e Kryetarit të Komunës së Deçanit z. Bashkim Ramosaj, 01-12320, dt.19.04.2024, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur, me dt.30.04.2024, merr këtë:

VENDIM

Për Hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027

Neni 1

Miratohet Propozimi i Kryetarit të Komunës z. Bashkim Ramosaj, për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027, që parandalon dhe trajtonë dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe dhunën në baza gjinore, të mbrojtë dhe të kontribuojë në eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave si dhe të ndërtojë mekanizmat e nevojshëm për ofrimin e mbështetjes ndaj viktimave të gjitha formave të dhunës të rregulluara me ligj.

Neni 2

Koordinatori/ja për Mekanizmin Koordinues Lokalë për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Bazë Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryetarit e koordinon dhe udhëheq procesin e hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027.

Neni 3

Më rastin e hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027 dhe kryerjes së procedurave të konsultimeve publike, kujdeset kryetari i komunës më qëllim të procedimit për shqyrtim dhe miratim pranë Kuvendit të Komunës.

Neni 4

Hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027 do të financohet nga Buxheti i Komunës së Deçanit, në shumën që përcaktohet me Vendim të veçantë në Kuvend.

Neni 5

Vendimi hynë në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Vetëqeverisje Lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen e komunës.

01.Nr.IV-5
Deçan,dt.30.04.2024

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

REPUBLIC OF KOSOVA REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E DEÇANIT OPSTINA DEÇAN	
№ i regjistruar K.K. Deçan AS	№ i regjistruar 14451
№ i regjistruar 01	№ i regjistruar 08.05.24



Bazuar në Ligjin Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nëni 30 paragrafët 30.4 dhe 30.5 dhe Ligji Nr.08/L-260 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 /neni 15 paragrafët 9 dhe 10 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 26 / 29 Dhjetor 2023), në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr.28 e datës 04.06.2008, dhe nenit 26 pika 2. të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, të datës 31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.30.04.2024, merr këtë:

V E N D I M

PËR RIDESTINIM TË MJETEVE BUXHETORE NGA KATEGORIA MALLRA DHE SHËRBIME NË KATEGORINË SUBVENCIONE

I.

Merret Vendimi për Ridestinim të mjeteve buxhetore nga kategoria Mallra dhe Shërbime në kategorinë Subvencione, sipas të dhënave të prezantuara në vijim:

- Mjetet financiare për ridestinim në vlerë prej 50,000.00 € (pesëdhjetmijeuro) janë: nga kategoria Mallra dhe Shërbime, Zyra e Kryetarit, kodi ekonomik:22/631/16015/130/0111, ridestinohen në kategorinë Subvencione, Zyra e Kryetarit, kodi ekonomik: 22/631/16015/200/0111.**

II.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdeset, Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Deçanit.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

IV.

Me Vendim njoftohen:MF-Departamenti për Buxhet dhe Financa, Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arhivi i KK Deçan.

01.Nr.IV-3

Deçan,dt.30.04.2024

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT MUNICIPALITY OF DEÇAN OPSTINA DEÇAN	
Nr. 14445	01
08.05.24	



Në bazë të kërkesës së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit-Departamenti i sportit, të dt.22.01.2024, nr.309-2024, për përgatitjen e dokumentacionit për ndërtimin e Pishinës gjysmë olimpike në Deçan- Vendimi i Kuvendit për ndarjen e lokacionit për Pishinë Gjysmë Olimpikë, ku kërkohet plotësim i dokumentacionit në pajtueshmëri me Ligjin e Ndërtimit Nr.04/L-110, **në pajtim me dispozitat e nenit 10, 11 dhe 15 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor**, duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenin 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), në bazë të nenit 22 dhe 26 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, me Rekomandim të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për Rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit, të dt.29.02.2024, Nr.933-2/24, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.30.04.2024, bie këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E PISHINËS GJYSMË OLIMPIKE NË DEÇAN

I.

Merret Vendimi për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e Pishinës Gjysmë Olimpikë në Deçan, sipas standardeve FINA (Federata Ndërkombëtare e Sporteve të Ujit) në bashkëpunim me MKRS-në (Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit).

II.

Lokacioni i caktuar për ndërtimin e Pishinës Gjysmë Olimpikë në Deçan, është në harmoni me dokumentet e planifikimit hapësinorë të Komunës së Deçanit(Plani Zhvillimor Komunal-PZHK), parcelë e planifikuar në PZHK për Sport dhe Rekreacion.

Parcela nr.00563-23, Njësia Kadastrale P-70505021-00563-23, me sipërfaqe S=4000m², Zona Kadastrale Deçan, pronar Komuna e Deçanit.

III.

Implementimin e këtij Vendimi do ta bëjnë: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Deçanit.


IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

V.

Pjesë përbërse të këtij vendimi janë :

- Skica grafike,
- Kopjet e planit dhe
- Certifikatat e njësisë kadastrale.



Me Vendim njoftohen: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.IV-7
Deçan,dt.30.04.2024

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



The image shows a handwritten signature in blue ink over a circular official stamp. The stamp contains the text: 'REPUBLIKA E KOSOVES', 'KOMUNA E DEÇANIT', 'KOMUNA', 'Kuvendi i Komunës së Deçanit', 'REPUBLIC OF KOSOVA', 'DEÇAN MUNICIPALITY', and 'Assembly'. The signature is written in a cursive style and overlaps the stamp.



Ne bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d) dhe nenit 14 paragrafi 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr.28 e datës 04.06.2008, në bazë të nenit 24, paragrafi 1, 2 dhe 3, nenit 25 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr.10/03, Prill 2019), në bazë të nenit 29 dhe nenit 30 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 22, 26 dhe 56 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, me propozimin e Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Deçanit, në mbledhjen e mbajtur me dt.30.04.2024, merr këtë:

V E N D I M

I. MIRATOHET propozimi i Kryetarit të Komunës së Deçanit, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme private.

II. Sipas pikës nr.I. të këtij vendimi këmbimi përfshinë:

1. Parcela kadastrale e identifikuar me certifikatë të pronësisë Nr.00362-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 360 m², Zona kadastrale Dashinoc, me kulturë Rrugë e pakategorizuar, e regjistruar në regjistrat kadastral në emër të: PASURI SHOQËRORE RRUGË PUBLIKE TË PAKATEGORIZUARA, në pronësi të Komunës së Deçanit, Sipërfaqja që këmbëhet 205 m².
2. Prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim është pjesa e parcelës Nr.00361-2 me sipërfaqe të përgjithshme prej 820m², vendi i quajtur Oborr, Shqyrtëzimi aktual Bujqësore-Kullosë e Klasës 3, Zona kadastrale Dashinoc, pronë private me pronar Faruk Sadikaj nga fshati Dashinoc, Sipërfaqja që këmbëhet 205 m².

III. Qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme private të përshkruara në pikën II. Të këtij vendimi është : Rregullimi i kufirit të ngastrës kadastrale 00362-0, Zona Kadastrale Dashinoc, me kulturë Rrugë e pakategorizuar, me sipërfaqe të tërsishme prej 360 m², e regjistruar në regjistrat kadastralë në emër të: PASURI SHOQËRORE RRUGË TË PAKATEGORIZUARA, Sipërfaqja e ngastrës nuk ndryshon, por ndryshon vetëm forma e sajë, duke u përshtatur me gjendjen faktike në teren, rrugën e asfaltuar nga Komuna e Deçanit.

IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe pronës së paluajtshme të pronarit privat.

V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhe dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbëhet.

VI. Prona e paluajtshme komunale që do të këmbëhet, e përshkruar në pikën II. Të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.

VII. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtorja për Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Deçanit.

VIII.Pjesë përbërse të këtij vendimi janë :

- Skica grafike,
- Kopjet e planit dhe
- Certifikatat e njësisë kadastrale.

IX.Vendimi hyn në fuqi 15(pasëmbëdhjet) dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7(shtatë) ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës në gjuhët zyrtare.

01.Nr.IV-6

Deçan,dt.30.04.2024

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



REPUBLIC OF KOSOVA REPUBLIKA E KOSOVES	
KOMUNA E DEÇANIT / DEÇAN MUNICIPALITY	
№/No.:	14446
Org./Org.:	K.K. Deçan AS
№/No.:	01
Be./Be.:	08.05.24
Tit./Tit.:	
DEÇAN DEÇANE	